

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Drejtuar: **BOE “EC Pro Partners” shpk me NUIS J67902012U dhe kuotë pjesëmarrje 90% & “ZEQILLARI CONSTRUCTION” sh.p.k. me NUIS L61912024O dhe kuotë pjesëmarrje 10%**

Adresa: Tirane Farke SAUK Rruga "Hamdi Sina", Pallatet FZ Construction (Prane Liqenit te Thate), Nd.5, H.14, Kati 1.

Adresa: Tiranë, Njesia nr 5, "Komuna e Parisit", Rruga "Osman Myderizi", Zona Kadastrale 8270, me Nr pasurie 6/426 –N8.

- **OE/BOE me nënkontraktor**

PO ☐

JO X

-**OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

PO ☐

JO X

Nëse po, të jepen dhënat:

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur.

Numri i Procedurës: **REF- 95816-08-11-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Restaturimi, Rikonstruksioni dhe Muzealizmi i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë – Seksioni D”.**

Fondi Limit: **164,126,906.77** (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtë pikë shtatëdhjetë e shtatë) lek pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 6 muaj.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 12.08.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike **BULETINI NR.52 DATE 17.08.2026**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto X
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “ARKONSTUDIO” shpk me NUIS L42019004I & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k. me NUIS L41513008A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 123,280,144.43 (njëqind e njëzetë e tre million e dyqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e katër pik dyzetë e tre) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

2. BOE “EC Pro Partners ” sh.p.k. me NUIS J67902012U & “ZEQILLARI CONSTRUCTION” sh.p.k. me NUIS L61912024O

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 131,240,159.51 (njëqind e tridhjetë e një million e dyqind e dyzetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pik pesëdhjetë e një) **lekë pa TVSH; 297.60 pike**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

3. OE “INA” sh.p.k. me NUIS J61814009W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 132,848,772 (njëqind e tridhjetë e dy milion e tetëqind e dyzetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH; 233.70 pikë**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

4. OE “FUSHA ” sh.p.k. me NUIS J61922018S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 139,163,107.13 (njëqind e tridhjetë e nëntë million e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatë pik trembëdhjetë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

5. BOE “AD - STAR ” shpk me NUIS J69102207W & “GRAMA” sh.p.k. me NUIS J77304712J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 149,211,959.09 (njëqind e dyzetë e nëntë million e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë pik zero nëntë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “ARKONSTUDIO” shpk me NUIS L42019004I & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k. me NUIS L41513008A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

Për plotësimin e pikës 2.3 **Kapaciteti teknik: nënpika 2.3.1 e cila përcakton:**

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **49%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **80,422,184.31** (tetëdhjetë milion e katërqind e njetzet e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër pike tridhjetë e një) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht : **328,253,813.54** (treqind e njetzet e tetë milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e trembëdhjetë pikë pesëdhjetë e katër)lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura të bën oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
 - Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

BOE ka paraqitur dokumentacionin e punimeve të ngjashme nga verifikimi i te cilës rezulton se anëtari i BOE APIS CONSTRUCTION shpk me kuotë pjesëmarrje 25.68% ka paraqitur një kontratë të vetme punime të ngjashme në të cilën është pjesëmarrës në kuotën 50%, Nr. 11471 Prot, date 19.06.2023, me objekt "Meremetim hidroizolim shakolla 9-vjecare" me vlerë totale 9,690,048 (Nëntë million e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e dyzet e tetë) lekë pa TVSH dhe vlerë korespoduese për këtë OE në shumën 4,845,024 leke pa tvsh. OE bazuar në kriterin e sipershënuar "Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim" duhet të paraqiste kontratë me vlerë jo më pak se 20,652,416.93 leke pa tvsh .

BOE skualifikohet për mospërmbushje të pikës 2.3.1 të kërkesave për kualifikim.

2. OE "FUSHA " sh.p.k. me NUIS J61922018S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

Për plotësimin e pikës 2.3 **Kapaciteti teknik: nënpika 2.3.11 e cila përcakton:**

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet te disponoje:

Licëse te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (**Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta**), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që

trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

OE ka paraqitur Liçense të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (**Për grumbullim, transportim, ruajtje i mbetjeve jo të rrezikshme dhe të rrezikshme**). Nga verifikimi i Ak - Miratimit bashkëlidhur licensës konstatohet se OE licensohet për veprimtarinë “Grumbullim, transportim, ruajtje i mbetjeve jo të rrezikshme dhe të rrezikshme”. Në pikën 4 “Kushtet e licensës” nënpika d. Përcaktohen shtojca 1 :lloji i mbetjeve që subjekti duhet të klasifikojë dhe përkatësisht me kodet:

- 16 MBETJE TË PASPECIFIKUARA NË LISTË 16 01 Mjete jashtë përdorimit nga mënyrat e ndryshme të transportit (duke përfshirë mjete jorugore) dhe mbetje nga çmontimi i mjeteve jashtë përdorimit dhe të mirëmbajtjes, (përveç 13, 14, 16 06 dhe 16 08)
- 13 MBETJE VAJRASH DHE MBETJE TE KARBURANTEVE TE LËNGSHME (përveç vajrave ushqimore dhe ato në kapitullin 05 12 19)
- 20 MBETJET URBANE (MBETJET SHITËPIAKE DHE TREGTARE, MBETJE INDUSTRIALE E INSTITUCIONALE TË NGJASHME) PËRFSHIRË FRAKSIONET E MBLEDHURA VEÇMAS.

Kjo license, nuk perputhet me licensën e kërkuar AK ku veprimtaria duhet të jetë “Grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta” e cila në Vendimin Nr. 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve” Tipat e mbetjeve në katalog” I përket kodit “17 Mbetje Nga Ndërtimet Dhe Prishjet (Përfshi Dhera Të Gërmuara Nga Zona Të Kontaminuara)”.

Referuar preventivit të objektit, zërat e punimeve janë zëra ndërtimi, konkretisht punime prishje, punime ndërtimi, prishje e shtresave të taraces deri në soletën e betonit, prishja e shtresave të betonit + pllakave deri në soletë, Prishja e kollonave, trarëve prej betoni të armuar, Prishja e murit me tulla pa pastrim të tyre , etj dhe Depozitimi i materialeve të ndërtimit (mbeturinave) në landfill, nga veprimtaria e të cilave lindin mbetje inertesh dhe jo mbetje nga çmontimi i automjeteve, mbetje vajrash nga karburante apo mbetje urbane, të cilat sipas VKM Nr. 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, kategorizohen në pikën 17 “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshin dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)përfshin kodin 17 MBETJE NGA NDËRTIMET DHE PRISHJET (PËRFSHI DHERA TË GËRMUARA NGA ZONA TË KONTAMINUARA)”;

17 01 Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika

17 01 01 Beton 17 01 02 Tulla

17 01 03 Tjegulla dhe qeramika

17 01 06 * Përzierje ose fraksione të ndara betoni, tullash, tjegulla dhe qeramikës që përmbajnë substanca të rrezikshme

.....etj

Në këtë kuptim, KVO gjykon, se OE me dokumentacionin e paraqitur nuk provon se është i pajisur me licensë e kërkuar nga AK, duke mplotësuar kështu kërkesën për kualifikim. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

BOE skualifikohet për mospërmbushje të pikës 2.3.11 të kërkesave për kualifikim

3. BOE “AD - STAR ” shpk me NUIS J69102207W & “GRAMA” sh.p.k. me NUIS J77304712J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

- BOE ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit në të cilën ka përcaktuar ndarjen në % dhe zërat e punimeve që do të realizojë secili OE.

Neni 4

Ndarja e Punimeve dhe Përqindja e Pjesëmarrjes

4.2 Shoqëria AD-STAR sh.p.k. do të realizojë punimet sipas kategorive me poshte :

- NP-1A Punime germimi ne toke
- NP-3D Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada.
- NS-1A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS-4A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-9A Punime strukturore speciale
- NS-18A Punime topogjeodezike

Përqindja e pjesëmarrjes në kontratë: 99%

4.2 Shoqëria Grama shpk do të realizojë punimet sipas kategorive me poshte:

- **NS-9A Punime strukturore speciale**

Përqindja e pjesëmarrjes në kontratë: 1%

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE konkretisht Licensa Profesionale e shoqërisë rezulton se Shoqëria Grama shpk nuk e zotëron kategorinë **NS-9A Punime strukturore speciale. Pra OE nuk zotëron licensen për ekzekutimin e punës së marë përsipër në këtë kontratë.**

2.3.12 Për plotësimin e Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
-----------	----------------------	--------------	------------------	----------------

1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Minieskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Minifadrome (mjet teknologjik)	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Kamion me vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Autobetoniere	copë	3	Në pronësi ose me qera
8	Pompe betoni / Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Paisje gjeodezike Total Station	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Elektrobetoniere/Betoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Pompe Suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Depozite uji min ne 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Vibrator betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Matrapik	copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Sondë për realizimin e pilotave	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Makineri per prerje hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Makineri per kthim hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Paisje niveluese për nivelim shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Pompë uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Armatura	m2	500	Në pronësi ose me qera

BOE nuk ka paraqitur asnje makineri për artikullin nr.21 “Pompë uji cop 1” dhe artikullin nr.22 “Armatura500m2”

- Për plotësimin e pikës 1/b b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; BOE ka paraqitur sigurimin e ofertës nga kompania Atlantik sh.a në të cilin konstatohet se siguri i është prerë vetëm në emër të OE AD STAR SHPK dhe jo në emër të bashkimit të operatorëve sic kërkohet në VKM 285/2021 “Për rregullat e prokurimit publik” nëni 88 “Bashkimi i Operatorëve ekonomik”, paragrafi 2 i cili përcakton:

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi

duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. **Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.**

BOE skualifikohet për mopërmbushje të kriterëve për kualifikim të sipërcituara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, : BOE “EC Pro Partners” shpk me NUIS J67902012U dhe kuotë pjesëmarrje 90% & “ZEQILLARI CONSTRUCTION” sh.p.k. me NUIS L61912024O dhe kuotë pjesëmarrje 10% me adrese: Tiranë Farke SAUK Rruga "Hamdi Sina", Pallatet FZ Construction (Prane Liqenit te Thate), Nd.5, H.14, Kati 1 dhe Tiranë, Njesia nr 5, "Komuna e Parisit", Rruga "Osman Myderizi", Zona Kadastrale 8270, me Nr pasurie 6/426 – N8. se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 131,240,159.51 (njëqind e tridhjetë e një million e dyqind e dyzetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pik pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, totali i pikëve të marra **297.60 pikë** është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.